

Udhëzim nr. 253, datë 10.4.2020 “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, për arsye të epidemisë së shkaktuar nga covid-19”

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2, të nenit 42 dhe të nenit 53, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbime të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; të germës “a”, të pikës 6.1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”; të nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, MSHMS nxjerr këtë udhëzim për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimin Social Shtetëror, Institutin e Shëndetit Publik, strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, i cili përcakton procedurat dhe veprimet konkrete të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Udhëzimi, përcakton se strukturat e mbrojtjes së fëmijëve tregojnë vëmendje të veçantë për trajtimin, sipas procedurave të përcaktuara, të rasteve të fëmijëve në nevojë.ç) të izoluar në shtëpi që nuk kanë akses në shërbime, si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët me sëmundje kronike;

Ky udhëzim, gjithashtu përcakton se fëmijët më aftësi të kufizuara, ndaj të cilëve merret masa emergjente e mbrojtjes ose masa e mbrojtjes për vendosjen e tyre në përkujdesje alternative, do të vendosen në institucione të përkujdesjes shoqërore për këto grupe përfituesish, duke i ofruar shërbim psikosocial dhe shërbim të specializuar, duke respektuar procedurat e përcaktuara në pikën 3 dhe 6 të kreut të këtij udhëzimi(Kreu III), në lidhje me mast mbrojtëse. (3. Fëmija qëndron në izolim, nën përkujdesje gjatë gjithë kohës që ai/ajo është e infektuar nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19. 6. Institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale marrin të gjitha masat për përcaktimin e një hapësire të posaçme për karantinimin e fëmijëve që janë brenda institucionit dhe shfaqin shenjat e COVID-19, por edhe për fëmijët të cilët vendosen në institucion me masë mbrojtje, deri në momentin e daljes së rezultateve pas testimit të tyre. Gjatë periudhës së karantinës fëmija mbikëqyret nga personeli shëndetësor dhe nga një punonjës social, të cilët janë të pranishëm gjatë gjithëkohës,për të mbështetur fëmijën dhe për të parandaluar përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.)

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2020/04/10/253/b729b35e-8f61-4bd9-be9f-089ac3797fe4>